



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL**  
**DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Tiranë, më 27.7.2026

**Njoftim për vende vakante në shërbimin civil në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural**

Në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, në zbatim të pikës 9, të Vendimit nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar, të Urdhrit nr. 93, datë 12.6.2024, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”,

Departamenti i Administratës Publike ka shpallur procedurat e lëvizjes paralele, si dhe pranim në shërbimin civil:

- Për lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil 1 (një) pozicion të lirë Specialist në Sektorin e Auditimit të Brendshëm për Skemat Kombëtare, në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm, në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, klasa e pagës IV-2.

<https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/7500>

Janë të ftuar të gjithë nëpunësit e interesuar, pjesë e shërbimit civil, si dhe kandidatët për pranim në shërbimin civil të aplikojnë për pozicionin vakant të shpallur. Në lidhjet përkatëse, mund të gjeni informacionin e plotë për kriteret, dokumentacionin, mënyrën dhe afatin e dorëzimit, si dhe përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin/et.

Për më shumë informacion ndiqni faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike në lidhjen:

<https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet>

**AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL**

